

BIBLIOTEKA
SHTETIT

Ramiz
Kelmendi

Heshtja
e armëve

roman

R + 3
RAMIZ KELMENDI

HESHTJA E ARMEVE



SHTËPIA BOTUËSE «NAIM FRASHËRI»

DY FJALË

Në romanin e Ramiz Kelmendit «Heshtja e armëve» trajtohen dy probleme shoqërore paralele edhe të gërshtuara ngushtë me njëra-tjetrën: problemi i çlirimt të gruas dhe të vajzës prej vargonje të skllavërisë poshtëruuese e patriarchale, që i bën lodra dhe plaçkë në dorën e prindërve e të burrave dhe, lidhur me këtë, edhe problemi tjetër i zgjidhjes së konflikteve me anë të armës, të gjakut.

Subjekti i romanit «Heshtja e armëve» në thelb është dramatik. Autori, pa ju shmangur vështirësive shoqërore shtron problemin e martesës me dashuri, duke llogaritur për arritjen e këtij qëllimi luftën e shumanshme që duhet bërë kundër fejesave në mituri, kundër lidhjeve fisnore pa parim, kundër zgjidhjes në mënyra të vjetra gati mesjetare të problemeve që shtron jeta e sotme shoqërore. Për ta qartësuar më mirë mendimin se kohët kanë ndërruar, dy problemet paralele janë mishëruar në dy ngjarje paralele kohësh të ndryshme: dikur prishja e krushqisë dhe dashuria paguheshin me kokë. Çdo shkelje zakonesh vulosej me gjak dhe gjaku kërkonte gjak deri në pambarim (*historia e Selman Sykës*), kurse sot — theksion autorit, — njerëzit duhet të janë më të arësyeshëm dhe të gjejnë një rrugë tjetër për zgjidhjen e ngatërrresave, rrugën e marrëveshjes e të mirëkuptimit. Për këtë në roman flitet gjerë lidhur me konfliktet që lindin prej da-

shurisë së «paligjshme» të Sokolit e Zojës, që përfshin në vorbullën e vet shumë familje. Autori përkrah dashurinë dhe mirëkuptimin, është kundër fejesave në mituri e me shkuesi dhe kundër gjakderdhjes. Ai kërkon «të heshtin armët». Kjo dëshirë fisnike duket qartë në roman dhe lexuesi ynë do të kujtojë, duke lexuar veprën, shumë histori të njashme që kanë ndodhur në të kaluarën sidomos në Shqipërinë e veriut. Po krahas kësaj, do të shënojmë se Ramiz Kelmendi nuk i ka shkuar dot gjer në fund luftës kundër patriarkalizmit dhe ka kërkuar një zgjidhje kompromisi, duke njojur edhe ai të drejtën që «të vjetrit» të gjykojnë e të vendosin për të rinjtë, ndonëse jo më me armë, po me arësy, sadoqë ka treguar gjithashtu se edhe vendimet e «kuvendeve» të tilla shqelmojen pa ceremoni prej të rinjve (rasti i *Shotës*). Edhe «arratisja» në qytet nuk është një zgjidhje e plotë dhe vendimtare shoqërore e problemit, megjithëse mund të pasqyrojë në sipërfaqe rrugën e rëndomtë që zgjidhet sot në të tilla raste. Letërsia nuk duhet t'i shmanget luftës, sado e ashpër që të jetë ajo. E reja duhet të bëhet e ndërgjegjshme për vështirësitet që ka përpara, se vetëm kështu do të bëhet më e vodusur në luftë për realizimin e idealeve të saj.

Edhe në ndërtimin kompozicional, edhe në stil, shkrimitari është përpjekur të ruajë paralelizmin duke lënë të zhvillohen njëkohësisht «kuvendet» e shqetësimet e «pleqve» dhe dashuria e të rinjve, që priren drejt qytetit të vendosur. Dashuria e të rinjve është poezia e jetës, prandaj autorri e ka nënvizuar këtë ide edhe me «intermexot» lirike, kurse «kuvendet» janë proza plot hollësi, ngatërrësa, kllapa e hallka zakonesh e traditash. Ndofta do të kishte qenë më mirë sikur stili i këtyre dy shtresave kompozicionale të kishte qenë më i unifikuar në dobi të një gjuhe e të një shprehje artistike më të kohës në pajtim me prirjen e përgjithshme të zhvillimit të letërsisë së sotme.

Romani «*Heshtja e armëve*» e njeh lexuesin jo vetëm me prozën e sotme të Kosovës, po edhe me disa probleme shoqërore që shqetësojnë popullsinë e saj.

Para tyre shkrepit:

QYTETI.

Një terratisje e vetëtimshme sysh. Soditja e kapsitur.

Frika.

Frrrikkaa.

FFFRRRIIKKKAAA.

Vajza.

«Të ndalemi».

Dora më dorë.

Djali.

«Ikim para».

Gishtërinjtë mes gishtërinjve.

Sytë qepen në panoramën e panjohur të qytetit. Rrabin zemrat e njoma në droe, në èndje, në etje...

Vajza stepi në vend.

Një të feksur të mendjes:

«Të kthehem!»

Përgjegjja e prerë e vendosur e duarve të dashuruara.

Të përqafuara.

Të lidhura.

Djali priu:

«Ikim para!»

Refrene në veshë:

IKIM PARA

IKIM para

Ikim para

Ikim

para

ra

a

«Vetëm një çast, të lutem»,
tha vajza.

Djali u ndal, por shikimin nuk e ktheu prapa.
Një lutje në sy të vajzës: edhe për një shikim
të vetëm
të fundit
lamtumirës

prapa. Vetëm edhe një herë.
Duart shtrëngohen edhe më fort.

«Jo, nuse, jo»,
u gjegj djali.

Gurra të ëmbla në shtat të vajzës:
N-U-S-E...

«Vetëm edhe një herë»,
tha vajza.

«Jo, nuse, jo»,
u gjegj djali. «Mos u kthe prapa... As edhe vetëm
një herë...»

«Vetëm edhe një herë»,
tha vajza. Me sy të qepur në prakun e një jete të re.
Të lakmuar ndoshta pikërisht pse me shumë të panjohura. Pse s'andejmi, i dukej, lind dielli. I saj. I tij.

«Shiko para, nuse!»
tha djali.

U shkund një ofshamë e thellë. Me pluhur.
Duart u shtrënguan në përqafim.
Edhe zemrat me inde të padukshme.

Vajza:

Nuk shikoi prapa.

Djali e vajza:

hynë

në

Q Y T E T ...

I

Ulur galuc në shpat, me sy të qepur në shtegun që vinte nga Lugu i Dashës, e kredhur në mendime të llah-tarshme, e përlotur, Vakja priste Rekun zemërngrirë dhe e mavjosur. Ajri i këndshëm i bjeshkës e i kullotave, ndaj të perënduar të diellit, ja zinte frymën. Disa herë madje, në atë të pritur plot ndjellakob nga lajmi që do t'i sillte, mendoi se zemra i pushoi së rrahuri.

Një zë i brendshëm nuk pushonte së thirruri:
— Zojë!.. Zojë!.. Zojë!..

E me sy të mendjes e shihte menjëherë para vetes, por tani disi ndryshe nga sa e njihet: nuk ishte e buzë-qeshur si rëndom, nuk e kishte më atë llastim rinor që i pëlqente aqë shumë; e shihte të mërzitur dhe me kokë të ulur.

I dukej se Haxhajt kanë rënë në fashë, se njeri nuk ka të gjallë, se nga gjithë ato brigje e livadhe, nga gjithë ato maya e qafa, kodra e brinja, kërsha e lugje, shihte vetëm varret: varret e Lulajve, varrin e Smajl Dedës, varret e katolikëve, varret e Cukajve e të Lekajve në Kodër të Zharit...

Më kot u përpoq të mblidhët veten. Në shpirtin e saj lëshonin rrënje fidane të një parandjenje të kobshme. Ishte e shastisur. Çfarë nuk sillte në mend, duke fërkuar duart plot nervozizëm. Sa dëgjonte thirrjet e së bijës, sa fjalët e Cymës, që i ranë si gurë, derisa mbushte bulerët me ujë te Gurra e Selmonajve:

— Tieva pej do grave tu Vrella e Cuke se e kishin pa pa Zojën ty' shkua xhad's madhe, pér Pejë.

Vakes ju ngjeth mishtë që nga tamthat e gjer te gjunjët. E dëgjoi mirë, apo vetëm i bënë veshët? Është në vete Cyma, apo flet jerm?¹⁾ Çfarë tha, çfarë? E kanë parë Zojën, sugareshën e bukuroshen e lokes, xhadës së madhe, pér Pejë? Është pér t'u besuar kjo?

Këmbëprerë, Vakja, as që e pa bulerën që ishte mbushur dhe uji rriddhët nëpër te duke u lëshuar lugut. E vështroi një herë Cymën me ngulm, duke dëshiruar të gjejë në fytyrën e saj më të voglën shenjë se nuk e ka përnjëmend, se vetëm u mahit me te²⁾, se pér të tretur kohë para asaj gurre dhe se, fundi, nuk ishte Cyma as e para as e fundit që mahitet me Vaken pér punë të së bijës, në të cilën i kishte mbetur syri jo vetëm gjithë meshkujve të katundit Haxhaj, por i kishte dalë zëri edhe në tërë Rugovën. Fytyra e Cymës ishte e vrejtur, pa asnjë shenjë shakaje, madje edhe një çikë e inatosur. Pas kësaj e pyeti Vakja, duke u përpjekur të mëshevë atë të dridhur gjithnjë e më të dukshëm të trupit:

— Po mahite, Cumë, he?

— Jo, Vakjo, jo. Bash pér t'ime e ka.

— Mos diell zi...

— Thaftmu goja mos paça tie kështu...

Reku as nuk priti të mbarojë Vakja së treguari pér çfarë i kishte folur Cyma d'he përnjëherë rendi në drejtim të Lugut të Dashës, ku i kulloste rëndom delet bija e tyre, Zoja.

— Reko! — thirri Vakja, me lot pér faqe, pas tij.

Pa ndalur hapin e madh dhe pa u kthyer nga ajo, Reku vetëm lëshoi nëpër dhëmbë:

— Ç'drenë³⁾ po do?

Vakja i shkoi edhe ca hapa pas, por diç i tha të ndalej; ndoshta ishte kjo ajo dëshira e saj tinzake që të jetë dëshmitare sa më e vonshme e së vërtetës së hidhur, ajo

1) përqart

2) bëri shaka

3) duan

lakmia e saj ndjellamirë: ndoshta Cyma, megjithatë, vëtëm është mahitur. Ka gjasa, ka! C'është e vërteta, nga ajo njeriu edhe mund të priste një gjë të këtillë. «Cyma», mendoi ajo, «a zebërligë, he voftë e liga me ta! Tybe qì s'a shegaritë¹⁾ me mua...»

Disa herë i fshiu lotët me facoletën e saj me thekë, pastaj edhe fërkoi sytë, por Reku nuk dukej asgjékundi. Asaj i mbushej mendja gjithnjë se kjo vonesë, pa më-dyshje, nuk është për të mirë. Po sikur t'i shohë, pas pak, babë e bijë bashkë duke u zdirgjur Lugut të Dashës? E delet e bucura, të rënduara nga kullotja, para tyre? Ju frigua një çast pezmit të Rekës: çfarë do t'i thotë? Pse dëgjon fjalë grash, «huptjau zo farën!»²⁾

Vështrimi i humbur i syve të mjegulluar i jepte fyttyrës së saj, edhe ashtu të vuajtur, një hije të rëndë. Në një shenjë kohe brofi në këmbë.

Dëgjoi, atje larg, një blegërimë. I hapi sytë katër dhesi nëpër mjegull, me një padurim të ethshëm, duke ngrehur e krisur gishtérinjtë e saj eshtakë, i pa një çast delet e menjëherë pas tyre, disi si të mos ecte nëpër tokë, si t'ishte në ajri, ju duk Zoja. Ishte me flokë të lëshuar, që ja shpupurishte era, e duart i dukeshin, ashtu të hapura, si dy flatra. E gjitha ju duk si ndonjë zanë mal, si e Bukura e Dheut dhesi, ndonëse ndaj të perënduar, agimi filloj të zbardhëllojë në lindje, Vakja hapi duart ta marrë në përqafim, ta shtrëngojë fort dhesi të mos e lëshojë kurër nga parzmat; ajo avitej gjithnjë. Vakja e shihet se ajo rend të madhe që t'i bjerë në gjë, e hareshme, e ngazë-lyer, e stërlumtur. Atëherë filloj t'i zgjatet ai shteg, gjithnjë e më shumë. Edhe Zoja, sa më shumë rrihete me flatra që t'i afrohet, largohej nga ajo. Vakja, me duar të zgjatura, me sy që donin ta përpinin atë pamje, e ta ndryrin përbrenda, bëri ca çapa para, gjithnjë e më e pafuqishme për ta ndalur, për ta mbajtur. Atëherë fërkoi sytë...

1) tallur

2) humbua, zot, farën!

Nuk pa asgjë. Kurrfarë delesh. As Zojën. Askend. Ul prapë galuc dhe filloj të qajë me zë, me të dënesura të thella.

Reku ju afrua thuaj mbi kokë, edhe delet kaluan, e Vakja e dëgjoi vetëm kur briti:

— C'po vajto, mos t'çeltë sahabi shnosh?

U çua me të shpejtë në këmbë, si e frikësuar, por edhe më shumë me dëshirë ta shohë, ndoshta, të bijën me të atin. Kot i fshiu lotët, kot i fërkoi sytë, kot priti fjalë nga i shoqi, fjalë që do t'ja kthenin prapë atë qetësi e do t'ja davarisnin dallgët që e vërtisnin sa andej-këndejej.

Reku vazhdoi para, duke vrapuar herë pas herë pas ndonjë deleje, që lagohej nga tufa. Vakja u shtang në vend një çast, duke mos u besuar syve të vet, duke menduar se edhe kjo është ndonjë nga parafytyrimet e saj ndjellazeza; përsëri ju kthyte Lugut të Dashës më shpresë se, megjithatë, do ta shohë Zojën duke u zdirgjur. Do t'i ketë britur i ati, ndoshta edhe do të ketë ngrehur dorën më te, edhe pse s'e ka zakon, e ajo e turpëruar para çobanëve e çobaneshave, ndoshta e përlotur, do të vijë, ngëc-ngëc e kadalë-kadalë, më prapa.

Zoja nuk dukej asgjëkundi. Vakja atëherë rendi për të zënë Rekun, shkoi ca çapa pas tij, duke mbajtur shumë me të vështirë hapin më te. Një kohë bukur të mirë nuk guxoi ta pyesë, ndonëse e tërë ishte bërë një pikë-pyetje e madhe: aqë vjet kishte martesë me te, por kurrnjëherë nuk i bëri asnë pyetje pa një ndjenjë zagushie e frike, gati në të dridhur.

Nuk u përbajt dot dhe, me gjysmë zëri, e pyeti:

— He, Reko... ?

E pa të mrrolur dhe, si të mos kishte dëgjuar pyetjen, rendi prapa njërsës dele. Vakja mendoi se e bëri këtë vetëm të mos detyrohet t'i përgjegjej. Kur u afrua prapë, asaj ju duk një herë se u mat të hapë gojën, por ai vetëm pështyti përtokë me neveri. Reku dukej se as nuk vërente praninë e saj, aqë më pak të dëgjojë pyetje. Shihej menjëherë: ishte bërë tym e flakë. Atë duf, që e ngërthente, përpiquej ta shfrynte disi duke u grahur deleve, duke i ndjekur me një thupër të gjatë e ndonjëherë edhe duke